

Më
Dana

18-06-2018

NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna Lipjan, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.169-7/16, e dt. 18.12.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt. 10.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Ferizaj, PP.II.nr.169-7/16, e dt. 18.12.2017, dhe kjo gjykatë lëshon:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

[REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Lipjan, i lindur më datë [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] me nr. personal [REDACTED], me profesion mekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e:

Me dt. 26.01.2016, rreth orës 21:00, në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë me të arritur në fashtin Babush, Komuna Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes", me targa të

regjistrimit [REDACTED] duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 68/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka hyrë në tejkalim dhe gjatë tentimit për tu kthyer në shiritin e djathtë e me pjesën e parë e godet automjetin e markës "VË T2", me targë të regjistrimit [REDACTED], të cilin e drejtonte [REDACTED] në pjesën e pasme të anës së majtë, me të cilin rast pos dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pëson [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 14.12.2017.

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej 200€ (dyqind/euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzet/euro) të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60.88 € (gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Detyrohet i pandehuri që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.169-7/16, e dt. 18.12.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] KK Lipjan, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënien-lëshimin e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit i dt. 27.11.2017, ekspertimi mjeko-ligjor i dt. 14.12.2017, fotografitë e vendit të ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, si dhe provat e tjera të bashkangjitura në lëndë, vërtetojnë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe shpenzimeve të procedurës është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.


Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.3209/17 e dt. 10.04.2018

Zyrtarja ligjore
Ganimete Avdiu

Gjyqtarja
Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.